



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 527 / Prot.

Tiranë, më 22 /06/2015

**VENDIM**  
**“ Për rrëzimin e ankesës ”**

Nr. 39 ,datë 22 / 06 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**V Ë R E N:**

Ankuesi/Qendra “Res Publica”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr.527 Prot., datë 01.06.2015, ndaj Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”. Ankuesi/ Qendra “Res Publica” ka kërkuar t’i vihen në dispozicion kopje të dokumenteve, konkretisht:

1. Kopje të urdhrimit/ave të prokurimit për prodhimin dhe transmetimin e spoteve televizive, reklamave si dhe njoftimeve të botuara në shtypin e shkruar.
2. Kopje të ftesës për negociata që i është bërë subjekteve dhe listën e mediave që i është dërguar ftesa.
3. Kopje të urdhrimit për ngritjen e Komisioneve për ndjekjen e procedurave për prodhimin/ transmetimin dhe blerjeve të spoteve publicitare, nëse ky komision nuk është ngritur me Urdhrin e Prokurimit.
4. Cili është linku ku është publikuar ftesa për oferta?
5. Kopje të Procesverbalit të vlerësimit me pikë të operatorëve pjesëmarrës.
6. Kopje të Raportit të Komisionit mbi procedurën e ndjekur, drejtuar titullarit.
7. Kopje të vendimit të titullarit për lidhjen e kontratës (nëse ka).
8. Kopje të kontratës së lidhur për prodhimin dhe transmetimin e spoteve publicitare dhe njoftimeve/reklamave të botuara në shtypin e shkruar.

Komisioneri, në përputhje me pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas së cilës për shqyrtimin e praktikës mund të informohet nga çdo person dhe burim tjetër, paraprakisht ka verifikuar statusin juridik të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për të përcaktuar nëse bën pjesë në përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rrjedhojë e të cilës është zbatimi ose jo i kërkesave të këtij ligji.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit funksionon në përputhje me Ligjin nr.10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar. Bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji, FSHZH është person juridik dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike.

Për sa më sipër rezulton se FSHZH nuk është autoritet publik sipas përkufizimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### **V E N D O S A:**

1. Rrëzimin tërësisht të ankesës nr. 527 Prot., datë 01.06.2015 të Qendrës “Res Publica”, ndaj Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 22.06.2015.

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**

